

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN	
02 Nr./Dr.	1013/19
Nr./Sp./Bil.	- 02 -
Data: / Datum	19.08.2019
VUSHTRRI - VUÇITRN	

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Palët Nënshkruese,

1. Komuna e Vushtrrisë, e përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës,
2. Kompania “All Stone “ SHPK., përfaqësuar nga **z. Muhamet Konushevci**, nr. biznesit 810845068, shfrytëzues i Gurores në fsh. Pasomë, Komuna e Vushtrrisë.

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është mirëmbajtja - shtruarja me asfalt e rrugëve lokale nga ana e kompanisë “All Stone “ SHPK. e cila e shfrytëzon guroren në fshatin Pasomë, në ngastrën kadastrale nr.622, ZK-le Pasomë (Sumë), duke filluar nga Gurorja – Gurëthyesi deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri – Mitrovicë, të cilat janë dëmtuar apo dëmtohen gjatë transportit të materialit guror.

Neni 2 **Obligimet – Përgjegjësitë**

2.1 Obligimet e përbashkëta të palëve të marrëveshjes:

- 2.1.1 Identifikimi i dëmtimeve të rrugëve lokale nëpër të cilat bëhet bartja e materialit gurorë nga gurorja – gurëthyesi në fshatin Pasomë deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri – Mitrovicë.
- 2.1.2 Mbikëqyrja e përbashkët në baza mujore e gjendjes së rrugës për sa i përket dëmtimeve eventuale me rastin e transportit të materialit gurorë nga vend punishtja (gurorja) deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri – Mitrovicë dhe raportimi në komunë për dëmtimet e shkaktuara.

2.2 Obligimet e Kompanisë “All Stone” SHPK,

- 2.2.1 Mirëmbajtja – asfaltimi i rrugëve lokale të dëmtuara apo dëmtohen, nëpër të cilat bëhet bartja e materialit gurorë nga gurëthyesi deri në rrugën magjistrale M2 Vushtri Mitrovicë.
- 2.2.2 Raportimi në komunë për punët e kryera rreth mirëmbajtjes së rrugëve të cekur në pikën paraprake.

2.3 Obligimet e komunës së Vushtrrisë,

- 2.3.1 Të zgjedhë - eliminojë pengesat eventuale nga banorët e fshatrave nëpër të cilat bëhet bartja e materialit guror, për sa i përket identifikimit të kufijve të rrugëve lokale që janë objekt i kësaj marrëveshje me rastin e kryerjes së punimeve të mirëmbajtjes – asfaltimit.
- 2.3.2 Përmes zyrtarit të komunës, përcjellja e zbatimit të kësaj marrëveshje dhe raportimi te kryetari i komunës.

Neni 3.

Mbikëqyrja – Pranimi i punëve,

3.1 Në emër të K. së Vushtrrisë: Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve: Nexhat Merovci, Menaxher i zyrës së projekteve të komunës, Ramiz Maliqi, Zyrtar për leje ndërtimore dhe Isa Latifi, gjeodet.

3.2 Në emër të Kompanisë “All Stone” SHPK, përfaqësuesi i autorizuar i saj.

Neni 4.

Kohëzgjatja

4.1 Kjo marrëveshje lidhet për periudhën kohore, nga dita e nënshkrimit deri në përfundim të afatit të licencës së kompanisë “All Stone” SHPK për shfrytëzim të gurores në fsh. Pasomë.

4.2 Kompania “All Stone” SHPK do të njoftoj Komunën e Vushtrrisë për datën e përfundimit të afatit të licencës për shfrytëzim të gurores përkatësisht përfundimin e shfrytëzimit të gurores e cila është objekt i kësaj marrëveshje.

Neni 5.

Hyrja në fuqi dhe zbatimi i marrëveshjes

5.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet menjëherë.

5.2 Brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, palët nënshkruese, përmes përfaqësueseve të tyre do të marrin masa në kuptim të nenit dy (2) të kësaj marrëveshje.


Vushtri, më 14.08 2019

“All Stone” SHPK


Z. Muhamet Konushevci, Drejtor



Komuna Vushtri


Z. Xhafer Tahiri, Kryetar